



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 01 shkurt 2021
Nr. ref.: RK 1696/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**rastet nr. KI147/20, KI148/20, KI149/20, KI150/20,
KI151/20 dhe KI152/20**

Parashtrues

Nezir Neziri dhe 5 të tjerë

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së 6 aktvendimeve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës,
të nxjerra ndërmjet 10 dhjetorit 2019 dhe 13 korrikut 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi kërkesës

1. Kërkesa KI147/20 është dorëzuar nga Nezir Neziri; kërkesa KI148/20 është dorëzuar nga Hisni Vojvoda; kërkesa KI149/20 është dorëzuar nga Sejdi Sejdija; kërkesa KI150/20 është dorëzuar nga Hajdin Vojvoda; kërkesa KI151/20 është dorëzuar nga Gani Mëziu; dhe kërkesa KI152/20 është dorëzuar nga Jusuf Aliu (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

2. Parashtruesit e kërkesës, Nezir Neziri, Hisni Vojvoda, Sejdi Sejdiya, Hajdin Vojvoda dhe Gani Mëziu janë me vendbanim në Komunën e Skenderajt, ndërsa parashtruesi i kërkesës Jusuf Aliu është me vendbanim në Komunën e Prishtinës. Parashtruesit e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) i përfaqëson Jahir Bejta, Drejtor i Shoqatës “Ngritja e Zërit”.

Vendimet e kontestuara

3. Parashtruesit e kërkesës i kontestojnë gjashtë (6) Aktvendime të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), si në vijim:
 1. Nezir Neziri (KI147/20) e konteston Aktvendimin Rev.nr.422/2019, të 10 dhjetorit 2019, të cilin ai e kishte pranuar më 24 janar 2020;
 2. Hisni Vojvoda (KI148/20) e konteston Aktvendimin Rev.nr.188/2020, të 18 qershorit 2020;
 3. Sejdi Sejdiya (KI149/20) e konteston Aktvendimin Rev.nr.37/2020, të 6 shkurtit 2020, të cilin ai e kishte pranuar më 10 korrik 2020;
 4. Hajdin Vojvoda (KI150/20) e konteston Aktvendimin Rev.nr.189/2020, të 13 korrikut 2020;
 5. Gani Mëziu (KI151/20) e konteston Aktvendimin Rev.nr.187/2020, të 18 qershorit 2020; dhe
 6. Jusuf Aliu (KI152/20) e konteston Aktvendimin Rev.nr.124/2020, të 2 qershorit 2020, të cilin ai e kishte pranuar më 19 korrik 2020. (Në tekstin e mëtejme: Vendimet e kontestuara.)

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesave është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimeve të kontestuara, me të cilat pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesve të kërkesës të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], paragrafin 2 të nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe nenin 15 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ).
5. Parashtruesi i kërkesës Nezir Neziri (KI147/20) ka kërkuar kthim në gjendje të mëparshme, përkritazi me afatin për dorëzimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me nenin 50 [Kthimi në gjendjen e mëparshme], të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e

mëtejme: Ligji), pasi ai nuk ka pasur mundësi të dorëzojë kërkesën brenda afatit katër (4) mujor.

Baza juridike

6. Kërkesat bazohen në paragrafin 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 47 [Kërkesa individuale] dhe 50 [Kthimi në gjendje të mëparshme] të Ligjit si dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 01/2018 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 6 tetor 2020, parashtruesit e kërkesës i parashtruan kërkesat e tyre në Gjykatë.
8. Më 12 tetor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues për rastin KI147/20 dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
9. Të njëjtën ditë, në pajtim me paragrafin (1) të rregullit 40 (Bashkimi dhe ndarja e kërkesave) të Rregullores së punës, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesave KI148/20, KI149/20, KI150/20, KI151/20 dhe KI152/20, me kërkesën KI147/20.
10. Më 21 tetor 2020, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave.
11. Në të njëjtën ditë, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore në Mitrovicë), që të dorëzojë fletëkthesat, të cilat dëshmojnë se kur parashtruesit e kërkesës në rastet KI147/20 dhe 149/20, i kanë pranuar Aktvendimet e kontestuara të Gjykatës Supreme. Gjykata gjithashtu kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë, që të dorëzojë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës KI152/20 e kishte pranuar Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.
12. Më 27 tetor 2020, Gjykata Themelore në Prishtinë e dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën, që dëshmon se parashtruesi i kërkesës në rastin KI152/20 Aktvendimin e kontestuar e ka pranuar më 29 korrik 2020.
13. Në të njëjtën ditë, Gjykata Themelore në Mitrovicë dorëzoi në Gjykatë fletëkthesat, të cilat dëshmojnë se parashtruesi i kërkesës në rastin KI147/20 Aktvendimin e kontestuar e ka pranuar më 24 janar 2020, ndërsa parashtruesi i kërkesës në rastin KI149/20, Aktvendimin e kontestuar e ka pranuar më 10 korrik 2020.
14. Më 20 janar 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Ndërmjet 25 tetorit 2013 dhe 25 qershorit 2019, parashtruesit e kërkesës në mënyrë individuale parashtruan padi në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj, ndërsa parashtruesi i kërkesës KI52/20 parashtroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Të gjithë parashtruesit e kërkesës paditë e tyre i kishin parashtruar kundër Qeverisë së Republikës së Serbisë, për kompensimin e dëmeve materiale dhe jo-materiale që iu shkaktuan atyre gjatë luftës, ndërmjet viteve 1998 dhe 1999.
16. Përgjatë periudhës 12 janar 2015 dhe 14 tetor 2019, Gjykata Themelore në Mitrovicë dhe Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendime individuale: C.nr.100/2018; C.Nr.475/2018; C.Nr.390/2013; C.Nr.470/2018; C.Nr.180/2019; dhe C.Nr.2107/19, hodhën poshtë paditë e parashtruesve të kërkesës si të palejuara dhe u deklaruan jokompetente për të vendosur lidhur me ato padi.
17. Parashtruesit e kërkesës paraqitën ankesa individuale në Gjykatën e Apelit, kundër aktvendimeve të lartcekura të Gjykatës Themelore në Mitrovicë dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Parashtruesit e kërkesës kërkuan që vendimet në fjalë të gjykatave themelore të anulohen dhe kërkesat e parashtruesve të kërkesës të shpallen të pranueshme.
18. Ndërmjet 10 majit 2016 dhe 20 nëntorit 2019, Gjykata e Apelit, përmes aktvendimeve individuale: Ac.nr.2116/19; Ac.Nr.5375/19; Ac.Nr.2027/15; Ac.Nr.5370/19, Ac.Nr. 5761/19; dhe AC.nr.4162/19, refuzoi ankesat e parashtruesve të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimet e Gjykatës Themelore në Mitrovicë dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë, respektivisht.
19. Secili nga parashtruesit e kërkesës, në mënyrë individuale, parashtroi kërkesë të veçantë për revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Ata kërkuan që kërkesat e tyre për revizion të aprovohen, të anulohen aktvendimet e Gjykatës së Apelit dhe të gjykatave themelore, çështjet e tyre të kthehen në rivendosje në gjykatat themelore apo të ndryshohen aktvendimet e Gjykatës së Apelit, në mënyrë që paditë e tyre të aprovohet.
20. Në ankesat e tyre, parashtruesit e kërkesës po ashtu pretenduan se ekzistojnë dispozita të tjera të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK), me të cilat rregullohet çështja e kompetencës për rastet e tyre. Sipas tyre, në këtë rast do të duhej të zbatohet dispozita e nenit 28 të LPK-së, e cila ka të bëjë me kompetencën e gjykatave në kontestet me element ndërkombëtar.
21. Ndërmjet 10 dhjetorit 2019 dhe 13 korrikut 2020, Gjykata Supreme, përmes Aktvendimeve individuale: Rev.nr.422/2019, Rev.nr.188/2020, Rev.nr./2020, Rev.nr.189/2020, Rev.nr.287/2020 dhe Rev.nr.124/2020, refuzoi kërkesat e secilit prej parashtruesve për revizion si të pabazuara.
22. Argumentet kryesore të Gjykatës Supreme, në secilin prej këtyre vendimeve, ishin përgjithësisht si në vijim: se çështja e parashtruar në paditë nuk bie në

kompetence të ndonjë gjykate të vendit, për faktin se në rastin konkret vijnë në shprehje normat e kolizionit të Ligjit, sipas të cilëve themelohet kompetenca e ndonjë gjykate të ndonjë vendi tjetër. Me dispozitën e nenit 37.1 të LPK, është paraparë se në qoftë se me ligj nuk është caktuar kompetenca ekskluzive territoriale e ndonjë gjykate tjetër, për procedimin e çështjes është kompetente gjykata e kompetencës së përgjithshme për palën e paditur. Për më tepër, Gjykata Supreme argumentoi se kur është fjala për konteste me element të huaj, gjykata e vendit është kompetente vetëm nëse kjo kompetencë ndërkombëtare rrjedh shprehimisht nga ndonjë marrëveshje ndërkombëtare ose nga vet ligji, ashtu siç është përcaktuar me nenin 28 të LPK. Prandaj, Gjykata Supreme arsyetoi se nuk qëndrojnë thëniet e revizionit se në rastin konkret gjejnë zbatim dispozitat e nenit 28 të LPK-së, në të cilën thirret paditësi, e me të cilën caktohet kompetenca e gjykatave tona në kontestet me element ndërkombëtar (të huaj), pasi që ato nuk mund të zbatohet në rastin konkret nga se, këtu nuk kemi të bëjmë as me persona fizikë të huaj, e as me persona juridikë të huaj, por me shtet të huaj, me të cilin deri në momentin aktual shteti i Kosovës në territorin e së cilës është shkaktuar dëmi, nuk ka të lidhur kurrfarë marrëveshje ndërkombëtare (bilaterale etj) për kompetencën e gjykatave vendore për këto lloje të kontesteve. Gjykata Supreme, gjithashtu, theksoi se në rastin konkret nuk qëndron as pretendimi i revizionit të paditësve se kemi të bëjmë me kompetencën territoriale të zgjedhur, sipas nenit 47 dhe nenit 51 të LPK, nga se sipas vlerësimit të kësaj gjykate, të dy gjykatat drejtë kanë vlerësuar se në bazë të dispozitës së nenit 39.1 dhe 2 të LPK-së për të vendosur në këtë kontest kundër Republikës së Serbisë është e kompetencës së përgjithshme territoriale gjykata në territorin e së cilës ndodhet Selia e Kuvendit të Serbisë.

Pretendimet e parashtrueseve të kërkesës

23. Pretendimet e parashtruesve të kërkesës janë identike, prandaj Gjykata i paraqet ato si pretendime të njëjta.
24. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me vendimet e Gjykatës Supreme janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenet: 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ) dhe nenin 15 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: DUDNJ).
25. Parashtruesit e kërkesës kanë tri pretendime kryesore: (i) zbatimin e parimit "*per loci*" [*ratione loci*], i cili, sipas parashtruesve të kërkesës, nënkupton që gjykatat e rregullta kanë kompetencë për shqyrtimin e padive në bazë të vendit ku është shkaktuar dëmi material dhe moral; (ii) detyrimin për zbatimin e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nga ana e gjykatave të rregullta; (iii) të drejtën e tyre për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe të drejtën për qasje në drejtësi.
26. Parashtruesit e kërkesës fillimisht i referohen çështjes së juridiksionit territorial, përkatësisht parimit "*per loci*". Në lidhje me këtë, ata pretendojnë se gjykatat e rregullta "*kanë zbatuar gabimisht ligjin e aplikuar referuar juridiksionit*

territorial të Gjykatës Themelore [...], nga se, gjykata territorialisht kompetente për gjykime të çështjeve juridike, kurdoherë është gjykata në territorin e së cilës është kryer krimi, dëmtimi moral përkatësisht material! Ky definim e qëndrim juridik valid përkon edhe me interesin e palës së dëmtuar, parimin e ekonomisë në procedurat gjyqësore dhe administrative, si dhe në përputhje me principin ndërkombëtar – per loci”.

27. Parashtruesit e kërkesës, duke iu referuar nenit 22 të Kushtetutës, pretendojnë që përderisa të drejtat dhe liritë të *“garantuara me Konventat, Marrëveshjet dhe Instrumentet ndërkombëtare, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërsëdrejti në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike”*, rrjedhimisht, *“paraqitja e aktpadive pranë gjykatave vendore është e mbështetur edhe në principin ndërkombëtar per loci [...]. Në vijim, parashtruesit e kërkesës nënvizojnë se “[...] me nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore dhe me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut nën piken 15, është e paraparë e drejta për një proces të rregullt gjyqësor [...]”.*
28. Më tej, parashtruesit e kërkesës, duke iu referuar nenit 21, paragrafit 2 të Kushtetutës, pretendojnë se gjykatat e rregullta *“nuk i kanë aplikuar standardet e avancuara ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Njëra nga standardet është dhënia e mundësisë palës së dëmtuar për inicimin e çështjes së kompensimit të demit moral dhe material të shkaktuar si rezultat i veprimit direkt nga ana e autoriteteve serbe si dhe mosveprimit të autoriteteve në parandalimin e shkeljes së ligjeve të cila kanë qenë në fuqi në kohën kur janë kryer krimet, neni 185 të LMD (G.Z. e ish RSFJ, nr. 29/78) dhe i shkeljes Konventave Ndërkombëtare nga ana e Republikës së Serbisë kundër popullatës civile shqiptare [...]”.*
29. Parashtruesit e kërkesës, duke iu referuar nenit 54 të Kushtetutës, gjithashtu deklarojnë se *“u është mohuar e drejta për mbrojtje gjyqësore, e drejta për qasje në drejtësinë vendore si dhe garancia institucionale për mbrojtjen e të drejtave të qytetareve [...]”.*
30. Në vijim, parashtruesit e kërkesës iu referohen disa shembujve nga praktika ndërkombëtare ku, sipas tyre, viktimat e Luftës së Dytë Botërore janë lejuar *“të paraqesin aktpadi individuale në gjykatat vendore për kompensim të demit të shkaktuar nga Gjermania”.* Në këtë drejtim, ata specifikojnë se në rastet e Greqisë dhe Italisë, individëve u është dhënë mundësia për të kërkuar kompensim për *“dëmet e shkaktuara nga Gjermania gjatë Luftës së Dytë Botërore në pajtim me principin ndërkombëtar ‘per loci’.”*
31. Përtej pretendimeve të përbashkëta të paraqitura më sipër, si çështje e veçantë, parashtruesi i kërkesës Nezir Neziri (KI147/20), kërkon që lidhur me afatin për paraqitjen e kërkesës së tij, të bëhet kthimi në gjendjen e mëparshme, në pajtim me nenin 50 [Kthimi në gjendjen e mëparshme] të Ligjit. Në mbështetje të këtij pretendimi, ai argumenton se nuk ka pasur mundësi të dorëzojë kërkesën brenda afatit katër (4) mujor, pasi nuk kishte qasje në dokumentacionin e nevojshëm për të paraqitur kërkesën e tij në Gjykatë, duke theksuar se *“si pasoje e Pandemise na u eshte urdhruar lirimi i te gjitha zyreve nga objekti i ish TMK-*

se, mece planifikohej qe objekti te shendrohet ne krantine, per strehimin dhe sherimin e te prekurve nga Kovid 9. [...] Ne ter matrialin e punes madje edhe inventarin e zyres e kemi pas te c'vedosur ne hapsirat e Kompanise te Ujselellsit Regjionl ne Mitrovica-Njesia ne Skenderaj.” Lidhur me këtë ai bashkëngjiti një Vërtetim nga Kompania Rajonale e Ujësjesit “Mitrovica”, të datës 5 tetor 2020, e cila thekson se “Konfirmojmë se dokumentacioni i OJQ “Ngritja e Zërit”, madje i tërë inventari i zyrës ka qëndruar në hapësirat e objektit të ujësjesit nga 09.03.2020-deri me 01.10.2020.”

32. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata, anulimin e vendimeve të gjykatave të rregullta dhe kthimin e rasteve në rishqyrtim.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

33. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse kërkesat i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
34. Si shënim fillestar, Gjykata vëren se objekti i çështjes së këtyre kërkesave të bashkuara, si dhe pretendimet e ngritura në këto kërkesa, janë të ngjashme me një mori kërkesash të tjera për të cilat Gjykata veçse ka vendosur (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI73/17, KI78/17 dhe KI85/17, parashtrues *Istref Rexhepi dhe 28 të tjerë*, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 tetorit 2017, rastet KI97/17, KI99/17, KI115/17 dhe KI121/17, parashtrues *Mala Mala, Ali Salihu, Nurije Beka dhe Xhevat Xhinovci*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 janarit 2018; rastet KI96/18, KI97/18, KI98/18, KI99/18, KI100/18, KI101/18, KI102/18, KI103/18, KI104/18, KI105/18, KI106/18, KI107/18, KI116/18, KI117/18, KI119/18 dhe KI128/18, parashtrues *Fehmi Hoti dhe 15 të tjerë*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 shkurtit 2019; rastet KI02/19, KI03/19, KI04/19 dhe KI05/19, parashtrues *Halil Mustafa dhe 3 të tjerë*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019; rastet nr. KI86/19, KI87/19, KI88/19, KI89/19, KI90/19 dhe KI91/19, parashtrues *Ibrahim Zenuni dhe pesë të tjerë*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 janarit 2020; dhe, rastet KI20/20, KI21/20, KI22/20 dhe KI23/20, Parashtrues: *Hazir Hakolli dhe 3 të tjerë*, Aktvendim për papranueshmëri i 22 korrikut 2020).
35. Duke iu kthyer rrethanave të rasteve konkrete, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:
- “1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
(...)
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
36. Në vazhdim, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesat individuale], nenit 48 [Saktësimi i kërkesës], nenit 49 [Afatet] dhe nenit 50 [Kthimi në gjendjen e mëparshme] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

37. Më tutje, Gjykata i referohet edhe Rregullores së punës, përkatësisht paragrafit (1) dhe (2) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë], të cilët përcaktojnë si në vijim:

Rregulli 39 i Rregullores së punës
[Kriteret e pranueshmërisë]

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit, dhe [...].”

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

38. Gjykata konstaton se të gjithë parashtruesit e kërkesës janë palë të autorizuar, të cilët kontestojnë një akt të një autoriteti publik, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu i kanë sqaruar të drejtat dhe liritë që ata pretendojnë se u janë shkelur, në pajtim me nenin 48 të Ligjit.
39. Po ashtu, Gjykata vëren se të gjithë parashtruesit, përveç Nezir Nezirit (KI147/20), e kanë dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin katër (4) mujor nga dita e pranimit të vendimit të kontestuar, të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.
40. Ndërsa lidhur me parashtruesin e kërkesës Nezir Neziri (KI147/20), Gjykata vëren se ai e ka pranuar Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, Rev.nr.422/19, më 24 janar 2020, ndërsa e ka dorëzuar kërkesën (KI147/20) në

Gjykatën Kushtetuese më 6 tetor 2020. Pra, kërkesa e tij është dorëzuar pas afatit prej 4 (katër) muajsh.

41. Megjithatë, parashtruesi i mësipërm kërkon nga Gjykata kthimin e afatit në gjendjen e mëparshme, për sa i përket afatit për dorëzimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me nenin 50 të Ligjit. Në lidhje me këtë, Gjykata vë në dukje se parashtruesi i kërkesës KI147/20 arsyeton kërkesën për rikthim të afatit duke theksuar se nuk ka pasur mundësi të dorëzojë kërkesën brenda afatit katër (4) mujor, pasi nuk kishte qasje në dokumentacionin e nevojshëm për të paraqitur kërkesën e tij në Gjykatë. Ai shton se *“si pasojë e Pandemise na u është urdhruar lirim i të gjitha zyreve nga objekti i ish TMK-se, mece planifikohej që objekti të shendërrohet në krantine, për strehimin dhe shtimin e të prekurve nga Kovid 9. [...] Ne të matrialin e punes madje edhe inventarin e zyres e kemi pas të c'vedosur në hapsirat e Kompanise të Ujellsit Regjionl në Mitrovice-Njesia në Skenderaj.”* Për të mbështetur argumentet e tij, ai bashkëngjit një Vërtetim nga Kompania Rajonale e Ujësllësit “Mitrovica” të datës 5 tetor 2020, e cila thekson se *“Konfirmojmë se dokumentacioni i OJQ “Ngritja e Zërit”, madje i tërë inventari i zyrës ka qëndruar në hapësirat e objektit të ujësllësit nga 09.03.2020-deri me 01.10.2020.”*
42. Lidhur me këtë Gjykata rikujton nenin 50 [Kthimi në gjendjen e mëparshme] të Ligjit, që përcakton se: *“Nëse parashtruesi pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, Gjykata Kushtetuese ka për detyrë që në bazë të kërkesës së parashtruesit ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme. Parashtruesi ka për detyrë të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nga mënjanimi i pengesës dhe të arsyetojë kërkesën në fjalë. Kthimi në gjendjen e mëparshme nuk lejohet nëse ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me këtë ligj.”*
43. Andaj, sipas nenit 50 të Ligjit, në mënyrë që të aprovohet kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme duhet të plotëson kushtet në vijim:
 1. parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë se pa fajin e tij/saj nuk ka qenë në gjendje të parashtojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar;
 2. parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nga mënjanimi i pengesës;
 3. parashtruesi i kërkesës ka arsyetuar kërkesën në fjalë; dhe,
 4. nuk ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me këtë ligj për paraqitjen e kërkesës në Gjykatë.
44. Në vlerësimin e kërkesës së parashtruesit për rikthim të afatit, Gjykata së pari, konsideron se parashtruesi i kërkesës KI147/20, pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar. Kjo, pasi që dokumentet e nevojshme për të paraqitur kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese, kanë qenë të mbyllura në objektin e Kompanisë Rajonale të Ujësllësit “Mitrovica”, si pasojë e rrethanave të krijuara nga pandemia Covid 19, dhe atë nga data 9 mars 2020 deri më 1 tetor 2020. Ky fakt vërtetohet nga Vërtetimi i lëshuar nga Kompania Rajonale e Ujësllësit “Mitrovica”, i datës 5 tetor 2020. Së dyti, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesën për kthimin

- në gjendjen e mëparshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nga mënjanimi i pengesës, ashtu si parashihet me nenin 50 të Ligjit, kjo pasi kërkesa e parashtruesit është dorëzuar në Gjykatë më 6 tetor 2020, ndërsa qasja në dokumentet e nevojshëm për të paraqitur kërkesën është krijuar më 1 tetor 2020 (siç dëshmohet nga Vërtetimi i lëshuar nga Kompania Rajonale e Ujësjetës "Mitrovica"). Së treti, parashtruesi ka argumentuar kërkesën e tij për kthim në gjendje të mëparshme, përkitazi me afatin për paraqitje të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese. Së katërti, parashtruesi i kërkesës e ka paraqitur kërkesën e tij pa kaluar një vit nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me këtë ligj për të paraqitur kërkesën në Gjykatë. Gjykata vëren po ashtu se në momentin që parashtruesit të kërkesës i është pamundësuar qasja në dokumentet e nevojshme, më 9 mars 2020 ka pasur ende afat për të paraqitur kërkesën e tij, pasi ai kishte pranuar aktvendimin e kontestuar më 24 janar 2020.
45. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës, KI147/20, e ka mbështetur dhe arsyetuar kërkesën e tij për kthimin në gjendjen e mëparshme, përkitazi me afatin për paraqitje të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me nenin 50 të Ligjit.
 46. Prandaj, Gjykata miraton kërkesën (KI147/20) e parashtruesit Nezir Neziri për kthimin në gjendjen e mëparshme, lidhur me afatin për paraqitje të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese. Rrjedhimisht, afati i parashtruesit për paraqitjen e kërkesës kthehet në gjendjen në të cilin ishte nga dita kur i është pamundësuar qasja në dokumentet e nevojshme, specifikisht më 9 mars 2020.
 47. Bazuar në si më sipër, rezulton se edhe kërkesa KI147/20 e parashtruesit Nezir Neziri e plotëson kriterin e përcaktuar me nenin 49 të Ligjit lidhur me afatin e paraqitjes së kërkesës, duke pasur parasysh që kërkesa e tij për rikthim të afatit është aprovuar nga Gjykata.
 48. Më tutje, Gjykata lidhur me të gjitha kërkesat e parashtruesve duhet të shqyrtojë nëse plotësohet kriteri i pranueshmërisë, i përcaktuar në rregullin 39 (2) të Rregullores së punës. Gjykata rithekson se rregulli 39 (2) i Rregullores përcakton se *"Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij"*.
 49. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës pretendojnë se gjykatat e rregullta u kanë shkelur disa të drejta të mbrojtura me Kushtetutë, KEDNJ dhe DUDNJ, duke vënë theksin posaçërisht në të drejtën për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave dhe të drejtën për një gjykim të drejtë.
 50. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se gjykatat e rregullta e kanë interpretuar gabimisht ligjin në fuqi kur i janë referuar juridiksionit territorial të Gjykatës Themelore. Ata, më tej, pretendojnë se gjykata në territorin e së cilës është shkaktuar dëmi është gjykatë kompetente për gjykim në çështjet e tyre. Si rrjedhojë, sipas parashtruesve të kërkesës, atyre u është mohuar e drejta në mbrojtje gjyqësore dhe qasje në drejtësi.
 51. Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesve të kërkesës, në thelb, kanë të bëjnë me interpretimin nga gjykatat e rregullta të dispozitave përkatëse ligjore

që rregullojnë kompetencën e tyre territoriale, gjegjësisht kompetencën për të vendosur përkitazi me paditë e parashtruesve.

52. Gjykata thekson qëndrimin e saj se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike, sikundër edhe interpretimet përkatëse ligjore, parimisht, hyjnë brenda juridiksionit të gjykatave të rregullta. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë respektimin e standardeve dhe të drejtave të garantuara me Kushtetutë, rrjedhimisht, ajo nuk mund të veprojë si gjykatë e “shkallës së katërt” (shih *mutatis mutandis*, në lidhje me doktrinën e “shkallës së katërt”, rastet e Gjykatës Kushtetuese KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012 paragrafi 33; si dhe rastet e bashkuara KI73/17, KI78/17 dhe KI85/17 parashtrues të kërkesës *Istref Rexhepi dhe 28 të tjerë*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 nëntorit 2017, paragrafët 46 dhe 47).
53. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata Supreme i ka shqyrtuar pretendimet e parashtruesve të kërkesës lidhur me interpretimin e bërë nga Gjykata e Apelit dhe gjykatat themelore, të dispozitave përkatëse ligjore lidhur me kompetencën për gjykim në rastet e parashtruesve.
54. Gjykata Supreme, gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, arsyetoi se gjykatat themelore dhe Gjykata e Apelit i kanë zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, kur kanë konstatuar se nuk kanë pasur juridiksion për të gjykuar në këto raste gjyqësore. Prandaj, Gjykata Supreme hodhi poshtë pretendimet e parashtruesve të kërkesës, duke arsyetuar se juridiksioni i përgjithshëm territorial është në gjykatën në territorin e së cilës është selia e Kuvendit të Republikës së Serbisë e cila nuk është në territorin e gjykatave të Kosovës.
55. Kështu, në aktvendimet e saj, Gjykata Supreme, ndër të tjera, arsyetoi se: *“në rastin konkret gjejnë zbatim dispozitat e nenit 28 të LPK-se, në të cilën thirret paditësi, e me të cilën caktohet kompetenca e gjykatave tona në kontestet me element ndërkombëtar (e huaj), nuk mund të zbatohet në rastin konkret, nga se, këtu nuk kemi të bëjmë as me persona fizik të huaj, e as me persona juridik të huaj, por me shtet të huaj, me të cilin deri në momentin aktual shteti i Kosovës në territorin e se cilës është shkaktuar demi, nuk ka të lidhur kurrfarë marrëveshje ndërkombëtare (bilaterale etj.) për kompetencën e gjykatave vendore për këto lloje të kontesteve. Gjykata Supreme po ashtu theksoi se nuk qëndron as pretendimi i revizionit të paditësit se në rastin konkret kemi të bëjmë me kompetencën territoriale të zgjedhur sipas nenit 47 dhe nenit 51 të LPK, të dy instancat gjyqësore drejtë kanë vlerësuar se në bazë të dispozitës së nenit 39.1 dhe të LPK-së të vendosur në këtë kontest kundër Republikës së Serbisë është e kompetencës së përgjithshme territoriale gjykata në territorin e së cilës ndodhet Selia e Kuvendit të Serbisë.”*
56. Gjykata konsideron se përfundimet e gjykatave themelore, Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme janë arritur pas një shqyrtimi të hollësishëm të të gjitha argumenteve dhe interpretimeve të parashtruara nga parashtruesit e kërkesës. Në këtë mënyrë, parashtruesve të kërkesës iu është dhënë mundësia që në të gjitha fazat e procedurës të paraqesin argumentet dhe interpretimet ligjore të cilat i konsiderojnë të rëndësishme për rastet e tyre.

57. Rrjedhimisht, Gjykata përfundon se procedurat në gjykatat e rregullta, të shikuara në tërësinë e tyre, ishin të drejta dhe se nuk mund të arsyetohet pretendimi për interpretime arbitrare ligjore nga ana e gjykatave të rregullta.
58. Në kontekstin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës lidhur me *“të drejtën e tyre në mbrojtje gjyqësore dhe qasje në drejtësi”*, Gjykata i referohet edhe praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), në të cilën është e detyruar të referohet sipas nenit 53 të Kushtetutës. Mbi këtë të fundit, Gjykata po ashtu vë në pah edhe praktikën e saj gjyqësore të ndërtuar mbi praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së ku është potencuar se ekzistojnë barriera procedurale të cilat i imponon parimi i imunitetit sovran të shteteve – si një nga parimet themeltare të së drejtës ndërkombëtare publike – në raport me procedurat gjyqësore që mund të zhvillohen kundër një shteti në gjykatat e brendshme të një shteti tjetër (shih rastet e bashkuara të Gjykatës Kushtetuese, KI96/18, KI97/18, KI98/18, KI99/18, KI100/18, KI101/18, KI102/18, KI103/18, KI104/18, KI105/18, KI106/18, KI107/18, KI116/18, KI117/18, KI119/18 dhe KI125/18, parashtrues *Fehmi Hoti dhe 15 të tjerë*, cituar më lart, paragrafët 58 dhe 59, shih, *mutatis mutandis*, edhe rastet e GJEDNJ-së të cituara në rastin e sipërpërmendur të Gjykatës Kushtetuese, *Jones dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesat 34356/06 dhe 40528/06, Aktgjykimi i 14 janarit 2014 dhe *Al-Adsani kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa 35763/97, Aktgjykimi i 21 nëntorit 2001).
59. Për më tepër, në rastin *Al-Adsani kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ ka argumentuar si në vijim: *“E drejta e qasjes në gjykatë mund t’i nënshtrohet kufizimeve, nëse nuk preket thelbi i së drejtës. Kufizimet e tilla duhet të ndjekin një qëllim legjitim dhe të jenë proporcionale. Njohja e imunitetit sovran të shteteve në procedura civile ndjekë qëllimin legjitim të respektimit të së drejtës ndërkombëtare [...]. Për sa i përket proporcionalitetit, për sa është e mundur, Konventa duhet të interpretohet në harmoni me rregullat e tjera të së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me imunitetin e shteteve. Kështu, masat e ndërmarra nga shteti të cilat pasqyrojnë rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare mbi imunitetin e shteteve, në parim, nuk mund të shikohen si kufizim jo-proporcional i të drejtës për qasje në gjykatë”*. Një qëndrim të tillë, për sa i përket tensionit në mes të parimit të imunitetit sovran të shteteve dhe të drejtës për qasje në drejtësi (gjykatë), e ka theksuar edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (shih, për shembull, rastin: *Gjermania kundër Italisë; Greqia si palë intervenuese*, Aktgjykimi i 3 shkurtit 2012).
60. Në kontekstin e argumenteve të mësipërme, Gjykata e konsideron të rëndësishme të theksojë faktin se vendimet e gjykatave të rregullta të Republikës së Kosovës, në rastet e parashtruesve të kërkesës, nuk kanë trajtuar të drejtën e tyre për të kërkuar kompensimin e dëmit, por vetëm kompetencën territoriale të gjykatave të Kosovës për të zhvilluar procedurë kundër një shteti tjetër.
61. Ndërsa, duke iu referuar edhe pretendimeve të parashtruesve rreth aplikimit të Konventës së Gjenezës në rastet e tyre gjyqësore, Gjykata vëren se parashtruesit vetëm i janë referuar kësaj Konvente por nuk kanë ofruar argumente të mëtutjeshme në lidhje me këtë pretendim (shih, për autoritetin e fundit në këtë drejtim, rastet e bashkuara të Gjykatës Kushtetuese, KI96/18, KI97/18,

KI98/18, KI99/18, KI100/18, KI101/18, KI102/18, KI103/18, KI104/18, KI105/18, KI106/18, KI107/18, KI116/18, KI117/18, KI119/18 dhe KI125/18, parashtrues *Fehmi Hoti dhe 15 të tjerë*, cituar më lart).

62. Gjykata rithekson qëndrimin e saj të përgjithshëm se vetëm fakti i thjeshtë se parashtruesit e kërkesës nuk pajtohen me rezultatin e vendimeve të Gjykatës Supreme, apo të gjykatave të tjera të rregullta, sikundër edhe vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës apo instrumenteve ndërkombëtare, nuk janë të mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI136/14, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, *Abdullah Bajqinca*, paragrafi 33).
63. Gjykata gjithashtu rikujton se faktet e paraqitura dhe pretendimet e parashtruesve të kërkesës janë pothuajse identike me disa kërkesa të mëhershme, për të cilat Gjykata ka vendosur se janë të papranueshme, si qartazi të pabazuara mbi baza kushtetuese (shih rastet KI73/17, KI78/17 dhe KI85/17, parashtrues *Istref Rexhepi dhe 28 të tjerë*, cituar më lart, rastet KI97/17, KI99/17, KI115/17 dhe KI121/17, parashtrues *Mala Mala, Ali Salihu, Nuriye Beka dhe Xhevat Xhinovci*, cituar më lart; rastet KI96/18, KI97/18, KI98/18, KI99/18, KI100/18, KI101/18, KI102/18, KI103/18, KI104/18, KI10S/18, KI106/18, KI107/18, KI116/18, KI117/18, KI119/18 dhe KI128/18, parashtrues *Fehmi Hoti dhe 15 të tjerë*, cituar më lart; rastet KI02/19, KI03/19, KI04/19 dhe KI05/19, parashtrues *Halil Mustafa dhe 3 të tjerë*, citua më lart; dhe rastet KI86/19, KI87/19, KI88/19, KI89/19, KI90/19 dhe KI91/19, parashtrues *Ibrahim Zenuni dhe pesë të tjerë*, cituar më lart). Të gjitha këto kërkesa kanë ngritur pretendime pothuajse identike me kërkesat e trajtuara në këtë vendim dhe, sikurse për ato raste, edhe në këto raste të bashkuara Gjykata konsideron se të njëjtat duhet të shpallen të papranueshme, si të pabazuara mbi baza kushtetuese.
64. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës në kërkesat e tyre nuk dëshmojnë se procedurat në gjykatat e rregullta kanë rezultuar në shkelje të të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i drejtpërdrejt i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
65. Prandaj, kërkesat e parashtruesve të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, dhe rrjedhimisht janë të papranueshme, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të neneve 47, 48 dhe 50 të Ligjit dhe rregullave 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 20 janar 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË APROVOJË kërkesën e parashtruesit të kërkesën KI147/20 për kthim në gjendje të mëparshme, për sa i përket afatit për paraqitje të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese;
- II. TË SHPALLË kërkesat e parashtruesve KI147/20, KI148/20, KI149/20, KI150/20, KI151/20 dhe KI152/20 të papranueshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi